**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**
**ENERGY REGULATORY OFFICE**

**Prishtinë, 29.03.2018**
**Kodi i ZRRE-së: V_944_2018**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Bazuar në:**

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);,
- Dispozitat e Nenit 4.2 dhe Nenit 22.2 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
- Dispozitat e Nenit 10.4 të Kodit të Rrjetit,
- Dispozitat e Nenit 10 dhe 11 të Doracakut të raportimit për sektorin e energjisë,
- Kërkesën për shqyrtim dhe aprovim të Raportit të Derogimeve për Kodin e Rrjetit, Kodi i Matjes, Rregullat e Tregut dhe Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, të datës 20.12.2017 të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT SH.A), me adresë: Rruga "Isa Boletini" Nr. 39, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

**në seancën e mbajtur me datë 29.03.2018, nxori këtë:**

# V E N D I M

**I.** **APROVOHET** kërkesa e KOSTT SH.A. për **Derogimet e dispozitave ligjore të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes, Rregullave të Tregut dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike** si në shtojcë të këtij vendimi.

**II.** Dispozitat tjera të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes, Rregullave të Tregut dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit mbesin në fuqi.

## Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 20.12.2017 ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A., për derogim në zbatimin e disa dispozitave nga Kodi i Rrjetit, Kodi i Matjes, Rregullat e Tregut dhe Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

- KOSTT SH.A. në kërkesën e saj ka sqaruar se: arsyet e kërkesës për derogim të dispozitave ligjore të Kodit të Rrjetit, kanë të bëjnë kryesisht me pengesat e sistemit të transmisionit, kërkesat për rezerva, kapacitetet interkonektuese, dispeçimi në kohë reale sipas Kodit të



Adresa: Rr. Dërvish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org

Balacimit, aranzhimet ballacuese, dispecimi në kushtet e papajtueshmërisë së furnizimit, mospërputhje me ngarkesën me gjenerimin në kohë reale, rregullimet kohore, reduktimi na ndërfrekuenca sipas kodit operativ, testimi i shartimit nga errësira dhe testimet e sistemit dhe për të cilat ka kërkuar derrogim (shtyrje të afatit të zbatimit të dispozitave) të Kodit të Rrjetit deri më 31.12.2018, dhe njëkohësisht ka kërkuar shtyrje të përmbushjes në zbatimin e dispozitave të Kodit të Matjes në lidhje me matjen e kapacitetit (fuqisë) dhe energjisë deri më 31.12.2018.

- Poashtu ka kërkuar derogim në zbatimin e dispozitave të Rregullave të Tregut, në lidhje me alokimin dhe tregtimin e kapaciteteve interkonektuese dhe për nominimet interkonektuese edhe për një periudhë gjegjësisht deri më 30.06.2018.

- KOSTT, ka kërkuar derogim (shtyrje të afatit në zbatimin e dispozitave të Licencës së OST, në lidhje me disponueshmërinë dhe mirëmbajtjen e të dhënave, blerjen ekonomike të aseteve, shërbimev3e dhe shërbimeve ndihmëse dhe obligimet e sigurimit, edhe për një periudhë gjegjeshit deri me 31.12.2018.

- KOSTT SH.A., ka sqaruar se arsyetimet lidhur me nenet që duhet të derogohen ku pjesa më e madhe e arsyeve është pamundësia e funksionimit si zonë/bllok rregullues, pamundësia e sigurimit të rezervave për shërbime ndihmëse që po ashtu lidhet me arsyen e parë, si dhe arsye tjera teknike/financiare. Për disa pika të kërkuara për derogim është kërkuar informacion shtesë si për sigurimin e rezervave për shërbime ndihmëse për të cilat sqarimi i KOSTT thekson se lidhen po ashtu me funksionimin si zonë/bllok rregullues, meqë ende konsiderohemi në kuadër të zonës rregulluese të EMS. Pikë tjetër është për grupet matëse, ku për disa nënstacione tanimë janë kryer instalimet, ndërsa për disa tjera pritet së shpejti. Pika 19.1 për blerjen ekonomike të aseteve është fshirë meqë kjo realizohet, mbetet vetëm pjesa e 19.2 për shërbime.

- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të Raportit të Derogimeve të dispozitave ligjore të Kodin të Rrjetit, Kodit të Matjes, Rregullave të Tregut dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, ka vlerësuar ato, dhe ka vendosur si në diapozitiv të këtij vendimi.,

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës..

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti.



Adresa: Rr. Dërvish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund ti drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së**

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfijaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të ZRRE-së.



Adresa: Rr. Dërvish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org

# Raporti i Derogimeve_Kodi i Rrjetit, Kodi i Matjes, Rregullat e Tregut dhe Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike

**Dhjetor 2017**

| Nr. | Kodi i Rrjetit | Neni | Paragrafi | Periudha e Derogimit e kërkuar (në vite/muaj) | Periudha e Derogimit e lejuar (në vite/muaj) | Periudha deri kur vlen Derogimi | Arsyeja e Kërkesës për Derogim |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Kodi i Planifikimit Operativ | **3 Kodi i Vlerësimit të Sistemit**<br><br>**3.4 Parashikimet e OST** | 3.4.3 (d)<br>**Pengesat e Sistemit të Transmisionit** | 1) 6 muaj<br>2) 6 muaj<br>3) 6 muaj<br>4) 1 vit<br>5) 6 muaj<br>6) 6 muaj<br>7) 6 muaj<br>8) 6 muaj<br>**9) 1 vit** | 1) 6 muaj<br>2) 6muaj<br>3) 6 muaj<br>4) 6 muaj<br>5) 6 muaj<br>6) 6 muaj<br>7) 6 muaj<br>**8) 6 muaj *(1 vit)***<br>**9) 1 vit** | 31.12.2013<br>30.06.2014<br>31.12.2014<br>30.06.2015<br>31.12.2015<br>30.06.2016<br>31.12.2016<br>**31.12.2017**<br>**31.12.2018** | Parashikimi i kongjestionit një ditë para (DACF), në aspektin teknik përmes softuerit NEPLAN, mund të realizohet (testimet janë bërë me sukses), por nuk mund të vihet në funksion derisa KOSTT të filloj operimin si Zonë Rregulluese/Bllok Rregullues. |
| | | **3.8 Kërkesat për Rezerva** | 3.8.1<br><br>3.8.2 | 1) 3 vit<br>2) 1 vit<br>3) 1 vit<br>4) 1 vit<br>5) 1 vit<br>6) 2 vite<br>7) 1 vit<br>8) 6 muaj<br>9) 1 vit<br>10) 6 muaj<br>11) 6 muaj<br>12) 6 muaj<br>13) **1 vit** | 1) 18 muaj<br>2) 1 vit<br>3) 6 muaj<br>4) 6 muaj<br>5) 6 muaj<br>6) 1 vit<br>7) 6 muaj<br>8) 6 muaj<br>9) 1 vit<br>10) 6 muaj<br>11) 6 muaj<br>**12) 6 muaj*(1 vit)***<br>**13) 1 vit** | 27.08.2010<br>30.06.2011<br>31.12.2011<br>30.06.2012<br>31.12.2012<br>31.12.2013<br>30.06.2014<br>31.12.2014<br>31.12.2015<br>30.06.2016<br>31.12.2016<br>**31.12.2017**<br>**31.12.2018** | Në mungesë të gjenerimit (Energjisë në dispozicion) të mjaftueshëm dhe për shkak të mungesës së kontratave për rezerva nuk ka mundësi të implementohet kjo dispozitë derisa të funksionalizohet Marrëveshja në mes të KOSTT dhe OST **(Marrëveshje Shërbimi për Ofrimin e Shërbimeve të Rregullimit Sekondar)** |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **3.9 Kapaciteti i interkoneksioneve** | 3.9.1<br>3.9.2 | 1) 1 vit<br>2) 1 vit<br>3) 2 vite<br>4) 13 muaj<br>5) 2 vite<br>6) 1 vit<br>7) 1 vit<br>8) 1 vit<br>9) 6 muaj<br>10) 1 vit<br>11) 1 vit<br>12) 6 muaj<br>13) 6 muaj<br>14) 6 muaj<br>15) 6 muaj<br>**16) 1 vit** | 1. 6 muaj<br>2. 1 vit<br>3. 7 muaj<br>4. 6 muaj<br>5. 1 vit<br>6. 6 muaj<br>7. 6 muaj<br>8. 1 vit<br>9. 6 muaj<br>10) 6 muaj<br>11) 6 muaj<br>12) 6 muaj<br>13) 6 muaj<br>14) 6 muaj<br>**15) 6 muaj*(1 vit)***<br>**16) 1 vit** | 24.11.2008<br>24.11.2009<br>30.06.2010<br>31.12.2010<br>31.12.2011<br>30.06.2012<br>31.12.2012<br>31.12.2013<br>30.06.2014<br>31.12.2014<br>30.06.2015<br>31.12.2015<br>30.06.2016<br>31.12.2016<br>**30.06.2017**<br>**31.12.2018** | Sipas rrethanave aktuale KOSTT nuk i menaxhon kapacitetet e interkonekcionit dhe nuk mund të parashihen importet dhe eksportet në linjat interkonektive deri sa të filloje operimi i KOSTT si Zonë Rregulluese/Bllok Rregullues.[1] |
| 2. | **Kodi i Balancit** | **2. Kodi i Dispeçimit**<br>**2.4 Procedura**<br>**2.4.3 Dispeçimi në kohë reale** | 2.4.3.2 | **1) 1 vit** | **1) 1 vit** | **31.12.2018** | Bazuar në marrëveshjen ekzistuese INTER-OST KOSTT-EMS, KOSTT kryen scheduling vetëm me EMS.<br>Pra shkëmbimi CAS (Control Area Scheduling) me vendet tjera fqinje nuk kryhen. |

[1] Parashikimi i eksporteve dhe importeve të energjisë elektrike në çdo linjë interkonektive në përputhje me alokimin e kapaciteteve interkonektive ka qenë deri më tani si kërkesë në derogim (Neni 12, paragrafi 2.4) nga Licenca për Operatorin e Sistemit të Transmisionit (paraprake) me nr.15/12. Tani në Licencën për Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike me nr. 15/17, Neni 18, paragrafi 2, nuk është specifikuar kërkesa e tillë, vetëm ceket sipas kërkesave dhe standardeve në Kodin e Rrjetit, prandaj e kemi larguar si kërkesë për derogim nga Licenca e OST-së, dhe kërkohet derogim vetëm sipas Kodit të Rrjetit.

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Kërkohet derrogim derisa KOSTT të filloje operimin si Zonë Rregulluese/Bllok Rregullues. |
| | | **2.4.4 Aranzhimet Balancuese** | 2.4.4.2 | 1) 3 vite<br>2) 2 vite<br>3) 2 vite<br>4) 1 vit<br>5) 1 vit<br>6) 6 muaj<br>7) 6 muaj<br>8) 1 vit<br>9) 6 muaj<br>10) 6 muaj<br>11) 6 muaj<br>**12) 1 vit** | 1) 3 vite<br>2) 1 vit<br>3) 6 muaj<br>4) 6 muaj<br>5) 1 vit<br>6) 6 muaj<br>7) 6 muaj<br>8) 1 vit<br>9) 6 muaj<br>10) 6 muaj<br>**11) 6 muaj *(1 vit)***<br>**12) 1 vit** | 01.11.2010<br>31.12.2011<br>30.06.2012<br>31.12.2012<br>31.12.2013<br>30.06.2014<br>31.12.2014<br>31.12.2015<br>30.06.2016<br>31.12.2016<br>**31.12.2017**<br>**31.12.2018** | Janë kryer testimet për funksionim të LFC me TC Kosova B dhe funksionim të LFC me OST.<br>Pritet që kjo të bëhet tërësisht funksionale me fillimin e operimit të KOSTT si Zonë Rregulluese/Bllok Rregullues. |
| | | **2.5 Dispeçimi në kushtet e pamjaftueshmërisë së furnizimit**<br><br>**2.5.2 Mospërputhja e ngarkesës me gjenerimin në kohë reale** | ( c ) | 1) 6 muaj<br>2) 1 vit<br>3) 1 vit<br>4) 6 muaj<br>5) 6 muaj<br>6) 6 muaj<br>7) **1 vit** | 1) 6 muaj<br>2) 6 muaj<br>3) 6 muaj<br>4) 6 muaj<br>5) 6 muaj<br>**6) 6 muaj *(1 vit)***<br>**7) 1 vit** | 31.12.2014<br>30.06.2015<br>31.12.2015<br>30.06.2016<br>31.12.2016<br>**31.12.2017**<br>**31.12.2018** | Nuk mund të implementohet për shkak të mungesës të rezervave shtesë nga ofruesit e shërbimeve ndihmëse. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **4.4.5 Rregullimi Kohor** | 4.4.5.1<br>4.4.5.2 | 1) 1 vit<br>2) 1 vit<br>3) 1 vit<br>4) 2 vite<br>5) 1 vit<br>6) 1 vit<br>7) 1 vit<br>8) 6 muaj<br>9) 6 muaj<br>10) 6 muaj<br>**11) 1 vit** | 1) 1 vit<br>2) 1 vit<br>3) 1 vit<br>4) 1 vit<br>5) 1 vit<br>6) 6 muaj<br>7) 6 muaj<br>8) 6 muaj<br>9) 6 muaj<br>**10) 6 muaj*(1 vit)***<br>**11) 1 vit** | 31.12.2010<br>31.12.2011<br>31.12.2012<br>31.12.2013<br>31.12.2014<br>30.06.2015<br>31.12.2015<br>30.06.2016<br>31.12.2016<br>**31.12.2017**<br>**31.12.2018** | Pritet që kjo të bëhet funksionale me fillimin e operimit të KOSTT si Zonë Rregulluese/Bllok Rregullues. |
| 3. | **Kodi Operativ** | **5.5.4 Reduktimi nga nënfrekuenca** | 5.5.4.1 | 1) 6 muaj<br>2) 6 muaj<br>3) 1 vit<br>4) 2 vite<br>5) 2 vite<br>6) 1 vit<br>7) 2 vite<br>8) 9 muaj<br>9) **6 muaj** | 1) 6 muaj<br>2) 6 muaj<br>3) 6 muaj<br>4) 1 vit<br>5) 1 vit<br>6) 1 vit<br>7) 1 vit<br>**8) 9 muaj *(1 vit)***<br>**9) 6 muaj** | 31.12.2011<br>30.06.2012<br>31.12.2012<br>31.12.2013<br>31.12.2014<br>31.12.2015<br>31.12.2016<br>**31.12.2017**<br>**30.06.2018** | Pas kalimit të NS 110/xx kV nga KEK-u në KOSTT, është vendos që mbrojtja nënfrekuente të jetë në anën sekondare të transformatorëve. Aktivizimi i mbrojtjeve nënfrekuente ka filluar në vitin 2013 dhe tani është në fazën finale. Mbrojtjet nën-frekuente ka mbetë të realizohen edhe në:<br>- NS Theranda, (që planifikohet në dy muajt e parë të vitit 2018), dhe<br>- NS Vallaçi (për këtë NS aktivizimi i mbrojtjeve nënfrekuente do të bëhet kur të krijohen kushtet për rehabilitimin e NS Vallaçit) |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 5.8.11 Testimi i Startimit nga Errësira | 5.8.11.1 | 1) 2 vite<br>2) 1 vit<br>3) 1 vit<br>4) 6 muaj<br>5) 1 vit<br>6) 2 vite<br>7) 1 vit<br>8) 1 vit<br>9) 5 vite<br>10) 1 vit<br>11) 1 vit | 1) 2 vite<br>2) 1 vit<br>3) 6 muaj<br>4) 6 muaj<br>5) 1 vit<br>6) 1 vit<br>7) 1 vit<br>8) 1 vit<br>9) 1 vit<br>10) 1 vit<br>11) 1 vit | 01.11.2009<br>31.12.2010<br>30.06.2011<br>31.12.2011<br>31.12.2012<br>31.12.2013<br>31.12.2014<br>31.12.2015<br>31.12.2016<br>**31.12.2017**<br>**31.12.2018** | Për qëllime të testimit, KOSTT nuk ka marrëveshje me OST-të tjera për realizim të simulimit të startimit nga errësira (zero). Për shkak se nuk mund të sigurohet puna në "ilotazhë" e njësive gjeneruese të KEK-ut, kjo aktualisht nuk është e mundur, me çka nënkuptohet se konsumi vendor duhet të mbetet pa furnizim deri sa mos të kthehen njësitë gjeneruese vendore në operim normal. Ky veprim do të kishte për pasojë kosto të lartë financiare, dhe pamundësi të justifikimit të një veprimi të tillë. |
| | | 8 Testimet e Sistemit | 8.4.2 | 1) 1 vit<br>2) 1 vit<br>3) 16 muaj<br>4) 2 vjet<br>5) 1 vit<br>6) 1 vit<br>7) 1 vit<br>8) 1 vit<br>9) 1 vit<br>10) 5 vite<br>11) 1 vit<br>12) 1 vit | 1) 6 muaj<br>2) 6 muaj<br>3) 6 muaj<br>4) 6 muaj<br>5) 6 muaj<br>6) 1 vit<br>7) 1 vit<br>8) 1 vit<br>9) 1 vit<br>10) 1 vit<br>11) 1 vit<br>12) 1 vit | 27.08.2009<br>27.02.2010<br>31.12.2010<br>30.06.2011<br>31.12.2011<br>31.12.2012<br>31.12.2013<br>31.12.2014<br>31.12.2015<br>31.12.2016<br>**31.12.2017**<br>**31.12.2018** | Testimet në lidhje me planet e startimit nga errësira (pika d), nuk mund të bëhet. KOSTT nuk ka marrëveshje me OST-të tjera për realizim të testimit të startimit nga errësira.<br><br>Kjo ndërlidhet me dispozitën 5.8.11 si më lartë. |

| Kodi | Neni | Paragrafi | Periudha e Derogimit e kërkuar (në vite/muaj) | Periudha e Derogimit e lejuar (në vite/muaj) | Periudha deri kur vlen Derogimi | Arsyeja e Kërkesës për Derogim |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Kodi i Matjes** | **Matjet e Kapacitetit (Fuqisë) dhe Energjisë** | **8.2.1.6** | 1) 1 vit<br>2) 6 muaj<br>3) 2 vjet<br>4) 14 muaj<br>5) 2 vite<br>6) 2 vite<br>7) 2 vite<br>8) 2 vite<br>9) 15 muaj<br>10) 15 muaj<br>**11)15 muaj** | 1. 1 vit<br>2. 6 muaj<br>3. 1 vit<br>4. 1 vit<br>5. 1 vit<br>6. 1 vit<br>7. 1 vit<br>8. 1 vit<br>9. 15 muaj<br>10. 12 muaj<br>**11. 1 vit** | 01.11.2008<br>01.05.2009<br>01.05.2010<br>30.06.2011<br>30.06.2012<br>30.06.2013<br>30.06.2014<br>30.06.2015<br>30.09.2016<br>30.09.2017<br>**31.12.2018** | - Kriteri nga Kodi i Matjes që njehsori kryesor dhe kontrollues duhet të lidhen si pajisje të vetme në bërthama të ndara për matje por me karakteristika të njëjta, tani më plotësohet për të gjitha linjat interkonektive përveç:<br>- L 155/2 NS Vallaç<br>– NS N. Pazar (derisa të bëhet rehabilitimi i NS Vallaç)<br>Kurse grupet matëse në NS të cilat nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara sipas Kodit të Matjes janë:<br>- NS Prishtina 2 (parashihet të përfundoj në fund të muajit Dhjetor 2017),<br>- NS Theranda (deri në fund të vitit 2018), kurse<br>- NS Vallaçi dhe NS Zubin Potok (kur të krijohen kushtet për rehabilitimin e NS Vallaçi) |

| Nr. | Kodi | Neni | Periudha e Derogimit e kërkuar(në vite/muaj) | Periudha e Derogimit e Lejuar (në vite/muaj) | Periudha deri kur vlen Derogimi | Arsyeja e Kërkesës për Derogim |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2. | **Rregullat e Tregut** | **Neni 7 Alokimi dhe Tregtimi i Kapaciteteve Interkonektive** | 1) 6 muaj<br>2) 3 muaj<br>3) 3 muaj<br>4) 6 muaj<br>5) 6 muaj<br>6) 6 muaj<br>7) 6 muaj<br>**8) 6 muaj** | 1) 6 muaj<br>2) 3 muaj<br>3) 3 muaj<br>4) 6 muaj<br>5) 6 muaj<br>6) 6 muaj<br>**7)6 muaj *(1 vit)***<br>**8) 6 muaj** | 31.12.2014<br>31.03.2015<br>30.06.2015<br>31.12.2015<br>30.06.2016<br>31.12.2016<br>**31.12.2017**<br>**30.06.2018** | **KOSTT** është aksionarë në **SEE CAO** dhe do ta shfrytëzojë atë si agjent në kryerjen e obligimeve që kanë të bëjnë me ankandin, alokimimin dhe transferin e Të Drejtave të Transferit Fizik. Kërkohet derrogim derisa KOSTT të filloje operimin si Zonë Rregulluese/Bllok Rregullues. |
| | | **Neni 10 Nominimet Interkonektive** | 1) 6 muaj<br>2) 3 muaj<br>3) 3 muaj<br>4) 6 muaj<br>5) 6 muaj<br>6) 6 muaj<br>7) 6 muaj<br>8) **6 muaj** | 1) 6 muaj<br>2) 3 muaj<br>3) 3 muaj<br>4) 6 muaj<br>5) 6 muaj<br>6) 6 muaj<br>**7)6 muaj *(1 vit)***<br>**8) 6 muaj** | 31.12.2014<br>31.03.2015<br>30.06.2015<br>31.12.2015<br>30.06.2016<br>31.12.2016<br>**31.12.2017**<br>**30.06.2018** | Obligimet nga kjo dispozitë ndërlidhen me obligimet për Alokimin dhe Tregtimin e Kapaciteteve Interkonektive sipas Nenit 7 të Rregullave të Tregut. Obligim i njëjtë është poashtu në Nenin 16, paragrafi 1(Interkonektorët) i Licencës së OST (OST bënë alokimin e kapaciteteve të linjave interkonektive me sistemet tjera në harmoni me procedurat e qarta dhe transparente për alokimin dhe shfrytëzimin e linjave interkonektive). |

| Nr | Licenca | Neni | Paragrafi | Periudha e kërkuar Derogimit (në vite/muaj) | Periudha e lejuar e Derogimit vite/muaj | Periudha deri kur vlen Derogimi | Arsyeja e Kërkesës për Derogim |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3. | **Licenca e OST** | **15. Disponueshmëria dhe mirëmbajtja e të dhënave** | 15.3 | 1) 1 vit<br>2) 6 muaj<br>3) 1 vit<br>4) 1 vit<br>5) 1 vit<br>6) 1 vit<br>7) 1 vit<br>8) 1 vit<br>9) 1 vit<br>10) 1 vit<br>11) 1 vit<br>12) 1 vit<br>13) 6 muaj<br>14) 6 muaj<br>15) 6 muaj<br>**16) 1 vit** | 1) 6 muaj<br>2) 6 muaj<br>3) 6 muaj<br>4) 6 muaj<br>5) 6 muaj<br>6) 6 muaj<br>7) 6 muaj<br>8) 6 muaj<br>9) 6 muaj<br>10) 1 vit<br>11) 1 vit<br>12) 1 vit<br>13) 6 muaj<br>14) 6 muaj<br>**15) 6 muaj** ***(1 vit)***<br>**16) 1 vit** | 24.11.2008<br>24.06.2009<br>24.11.2009<br>30.06.2010<br>31.12.2010<br>30.06.2011<br>31.12.2011<br>30.06.2012<br>31.12.2012<br>31.12.2013<br>31.12.2014<br>31.12.2015<br>30.06.2016<br>31.12.2016<br>**31.12.2017**<br>**31.12.2018** | Derisa të fillojë operimi i KOSTT si Zonë Rregulluese/Bllok Rregullues, nuk mund të bëhet bëhet mirëmbajtja dhe publikimi i të dhënave për:<br>- Kapacitetet ndërkufitare,<br>- Funksionimin e interkonektorëve, si dhe<br>- Menaxhimin e kongjestioneve. |
| | | **19 Blerja ekonomike e aseteve, shërbimeve dhe shërbimeve ndihmëse** | ~~19.1~~<br>19.2 | 1) 6 muaj<br>2) 6 muaj<br>3) 1 vit<br>**4) 1 vit** | 1) 6 muaj<br>2) 6 muaj<br>**3) 1 vit**<br>**4) 1 vit** | 30.06.2016<br>31.12.2016<br>**31.12.2017**<br>**31.12.2018** | Që nga 1 Qershor 2017 KOSTT blen/shet energji Furnizuesit publik (KESCO) për nevoja të përmbushjes së obligimeve nga Programi i Kompensimit, kurse nga 1 Shtator 2017, KOSTT është duke i blerë Humbjet e rrjetit në ankandet ditore të organizuara nga OT. **Marrëveshje Shërbimi për Ofrimin e** |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | **Shërbimeve të Rregullimit Sekondar** është e nënshkruar me 17 dhjetor 2015, dhe do të hyj në fuqi dhe do të prodhojë efekte vetëm në datën kur të gjitha kushtet e specifikuara (Neni VIII i Marrëveshjes) të jenë përmbushur plotësisht. |
| | | **31. Obligimi i Sigurimit** | 31.1 dhe 31.2 | 1. afat i pacaktuar<br>2. 6 muaj<br>3. 6 muaj<br>4) 6 muaj<br>5) 1 vit<br>6) 1 vit<br>7) 1 vit<br>8) 1 vit<br>9) 1 vit<br>**10) 1 vit** | 1) Afat i pacaktuar<br>2) 1 vit<br>3) 6 muaj<br>4) 6 muaj<br>5) 6 muaj<br>6) 6 muaj<br>7) 6 muaj<br>8) 6 muaj<br>9) **6 muaj** ***(1 vit)***<br>**10) 1 vit** | Afat i pacaktuar<br>31.12.2013<br>30.06.2014<br>31.12.2014<br>30.06.2015<br>31.12.2015<br>30.06.2016<br>31.12.2016<br>**31.12.2017**<br>**31.12.2018** | KOSTT edhe më tutje ka shpreh interesim nëse ndonjë nga Kompanitë vendore është e gatshme për të ofruar shërbimin për sigurimin e aseteve të transmisionit.<br>KOSTT ka angazhuar konsulencë për të ndihmuar stafin për përgatitjen e Politikës për sigurimin e aseteve. Në bazë të kësaj Politike do të përgatitet dokumentacioni për publikim të tenderit për sigurim të aseteve.<br>Në rast se do të ketë sukses publikimi i tenderit dhe blerja e këtij shërbimi, KOSTT do të njoftojë ZRRE-në për këtë. |

Fund i dokumentit